



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Ekstra 85

18 shkurt

2013

P Ë R M B A J T J A

Faqe

VENDIME TË GJYKATËS EUROPIANE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT

Vendim i GJEDNJ datë 15.1.2013	Çështja “Themeli kundër Shqipërisë”, aplikimi nr. 63756/09..	3
Vendim i GJEDNJ datë 15.1.2013	Çështja “Tushaj kundër Shqipërisë”, aplikimi nr. 13620/10....	6
Vendim i GJEDNJ datë 8.1.2013	Çështja “Qama kundër Shqipërisë dhe Italisë”, ankimi nr. 4604/09.....	10
Vendim i GJEDNJ datë 23.10.2012	“Vjollca Cekani kundër Shqipërisë”, kërkesë nr. 54188/08.....	21

SEKSIONI I KATËRT

ÇËSHTJA THEMELI KUNDËR SHQIPËRISË
(APLIKIMI NR. 63756/09)

VENDIM
STRASBURG
15 janar 2013

Në çështjen Themeli kundër Shqipërisë,
Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut (seksioni i katërt), e mbledhur në një Komitet të përbërë nga:

George Nicolaou, *president*

Zdravka Kalaydjieva

Faris Vehabović, *gjyqtarë*

dhe Fatoş Arac¹⁾, *zëvendëssekretar i seksionit*

Pasi ka diskutuar me dyer të mbyllura më 11 dhjetor 2012,

Lëshon vendimin e mëposhtëm, i cili u miratua në po atë ditë:

PROCEDURA

1. Çështja filloi me një aplikim (nr. 63756/09) kundër Republikës së Shqipërisë, paraqitur në Gjykatë sipas nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (konventa) nga një shtetas shqiptar, Z. Jorgji Themeli (ankuesi), më 5 nëntor 2009.

2. Ankuesi përfaqësohej nga Znj. E. Kokona, avokate, e cila e ushtron aktivitetin e saj në Tiranë. Qeveria shqiptare (qeveria) përfaqësohej nga agjenti i saj, Znj. L. Mandia e Zyrës së Avokatit të Shtetit.

3. Më 11 korrik 2011, aplikimi iu komunikua qeverisë.

FAKTET

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

4. Ankuesi ka lindur në vitin 1942 dhe jeton në Tiranë.

5. Pas pushimit të ankuesit nga puna në vitin 2003, më 19 janar 2004, Gjykata e Rrethit Tiranë urdhëroi punëdhënësin e tij, Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (Ministria), të paguante rrogën e tij për të gjithë periudhën gjatë së cilës ai mbeti i papunë. Ky vendim u bë i formës së prerë më 2 shkurt 2007, pas refuzimit që Gjykata e Lartë i bëri apelimit të punëdhënësit.

6. Më 10 shkurt 2005, u lëshua urdhri për zbatim.

7. Nga 1 janari 2006 deri më 31 janar 2007, ankuesit iu paguan rregullisht pagat mujore si rezultat i përfshirjes së emrit të tij në listën e pritjes së punëdhënësit, duke qenë se nuk iu pagua asnjë rrogë për periudhën midis viteve 2003 dhe 2006.

8. Më 2 shkurt 2009, përmbaruesi vendosi të ndërpriste zbatimin me argumentin se shuma e prapambetur ishte paguar. Ankuesi e kundërshtoi vendimin e përmbaruesit.

9. Më 30 prill 2010, Gjykata e Rrethit Tiranë mori vendim në favor të ankuesit dhe urdhëroi përmbaruesin të vazhdonte me procedurat e zbatimit të vendimit. Ajo vendosi se punëdhënësi i kishte paguar ankuesit shumën prej 2,065,101 lekë shqiptarë (të gjitha) nga një total prej 2,887,500 i gjithi, i përcaktuar për të për periudhën midis 2003 dhe 2006.

10. Më 30 qershor 2011, pas apelimit të përmbaruesit, Gjykata e Apelit e mbështeti atë vendim.

11. Më 18 janar 2012, Ministria urdhëroi pagesën e shumës së mbetur.

12. Më 8 mars 2012, vendimi për borxhin e ankuesit u zbatua plotësisht.



II. LIGJI VENDAS DHE PRAKTIKA PËRKATËSE

13. Ligji respektiv vendas dhe praktika janë përshkruar në çështjet e *Qufaj Co. sh.p.k. kundër Shqipërisë* (nr. 54268/00, §§ 21-26, 18 nëntor 2004) dhe *Gjyli kundër Shqipërisë* (nr. 32907/07, §§ 19-28, 29 shtator 2009).

LIGJI

14. Ankuesi parashtroi se moszbatimi i vendimit të Gjykatës së Rrethit Tiranë, i datës 19 janar 2004, siç mbështetet edhe nga vendimi i Gjykatës së Lartë, i datës 2 shkurt 2007, ka shkelur të drejtat e tij sipas neneve 6§1 dhe 13 të konventës, ashtu si edhe në përputhje me nenin 1 të protokollit të konventës, të cilët pohojnë si më poshtë:

Neni 6 § 1

“Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ... çdonjërit i jepet e drejta për t’u dëgjuar ... në mënyrë të drejtë ... nga një ... gjykatë”

Neni 13

“Çdonjëri, të drejtat dhe liritë e të cilit, siç parashtrohen në konventë, dhunohen, do të marrë një kompensim përpara një autoriteti kombëtar, pavarësisht faktit se dhunimi mund të jetë bërë nga persona, të cilët veprojnë nën një kompetencë zyrtare.”

Neni 1 i protokollit nr. 1

“Çdo individ human apo ligjor ka të drejtën të gëzojë pronat e tij. Asnjë nuk privohet nga pronat e tij, përveçse kur ato janë në interesa publike dhe subjekte të kushteve të parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të ligjit ndërkombëtar.

Megjithatë, parashikimet e mëparshme nuk do të zvogëlojnë të drejtën e një shteti t’i zbatojë këto ligje për aq kohë sa është i nevojshëm kontrolli mbi pronën në përputhje me interesin e përgjithshëm, apo edhe pagesa e taksave, kontributeve apo penalteteve të tjera.”

I. KËRKESA E QEVERISË PËR TA ANULUAR ÇËSHTJEN E APLIKIMIT SIPAS NENIT 37 TË KONVENTËS

15. Me anë të një letre të datës 18 janar 2012, qeveria paraqiti një deklaratë të njëanshme me synimin për të zgjidhur çështjen e ngritur nga aplikimi.

16. Ankuesi i kërkoi Gjykatës të kundërshtonte kushtet e paqarta të të deklaratës së njëanshme të qeverisë.

17. Pasi studioi kushtet e deklaratës së njëanshme të qeverisë, Gjykata mendon se nën rrethanat specifike të çështjes së ankuesit, ajo nuk ka baza të mjaftueshme për të konkluduar se respekton të drejtat e njeriut, siç përcaktohet në konventë dhe në protokollin e saj, dhe nuk i kërkon asaj që të vazhdojë ekzaminimin e çështjes (shiko, midis të tjerëve, *Choumakov kundër Polonisë* (nr. 2), nr. 55/777/08, §§ 37-40, 1 shkurt 2012 dhe *Ruprecht kundër Polonisë*, nr. 39912/06, §§ 25-27, 21 shkurt 2012).

18. Kështu, Gjykata e kundërshtoi kërkesën e qeverisë për të anuluar aplikimin sipas nenit 37 të konventës dhe do të ndjekë, sipas rastit, ekzaminimin e tij të pranueshmërisë dhe të drejtave ligjore të çështjes.

II. PRETENDIMI PËR DHUNIM TË NENEVE 6 § 1 DHE 13 TË KONVENTËS DHE NENIT 1 TË PROTOKOLLIT NR. 1 TË KONVENTËS

A. Pranueshmëria

19. Sipas asaj çka thuhet në nenin 35 § 3 të konventës, Gjykata vëren se këto ankesa nuk janë të pabaza. Më tej ajo vëren se ato nuk janë të papranueshme në ndonjë pikë të caktuar. Për këtë arsye, ato duhet të deklarohen të pranueshme.

B. Përmbajtja e çështjes

20. Ankuesi parashtrroi faktin se zbatimi i vendimit final në favor të tij është shtyrë për një kohë të gjatë, pasi vendimi u zbatua vetëm më 8 mars 2012. Pavarësisht se ishte përfshirë në listën e pritjes së punëdhënësit, ai deklaroi se mungesa e një kompensimi efektiv dhe rrethanat e çështjes së tij “e detyruan” atë të aplikonte për një tërheqje të hershme nga puna.

21. Qeveria parashtrroi faktin se vendimi u zbatua përfundimisht më 18 janar 2012. Për më tepër, ankuesi ishte përfshirë në listën e pritjes së punëdhënësit që më 1 janar 2006, dhe moszbatimi i vendimit i referohet një periudhe vetëm midis 10 marsit 2003 dhe 1 janarit 2006.

22. Gjykata vëren se vendimi në favor të ankuesit u zbatua përfundimisht më 8 mars 2012, 5 vite pasi u bë i formës së prerë më 2 shkurt 2007 (shiko *Gjyli*, cituar më sipër, § 33). Qeveria nuk paraqiti asnjë justifikim të çfarëdolloji për këtë zbatim vendimi të vonuar.

23. Për më tepër, Gjykata kujton se nuk ekziston asnjë kompensim vendas për sa ka të bëjë me zbatimin e vonuar të vendimit apo me moszbatimin e një vendimi final të gjykatës (*shiko Pluto dhe të tjerët kundër Shqipërisë*, nr. 609/07, §§ 33-35, 20 korrik 2010; dhe *Gjyli*, cituar më sipër, §§ 55-60).

24. Për sa i përket çështjes së saj ligjore të mirorganizuar mbi këtë rast (*Qufaj Co. sh.p.k.*, cituar më sipër; *Gjyli*, cituar më sipër; dhe *Pluto dhe të tjerët*, cituar më sipër), Gjykata konstaton se ka pasur shkelje të nenit 6 § 1 të konventës dhe të nenit 1 të protokollit nr. 1, në lidhje me zbatimin e vonuar në datën 8 mars 2012 të vendimit të Gjykatës së Lartë të datës 2 shkurt 2007 dhe një shkelje të nenit 13 të konventës për arsye se ankuesit nuk iu bë një kompensim efektiv vendas për të shlyer dëmin e shkaktuar nga një zbatim i tillë i vonuar.

III. ZBATIMI I NENIT 41 TË KONVENTËS

25. Neni 41 i konventës parashikon:

“Nëse Gjykata konstaton se ka pasur shkelje të konventës ose të protokolleve dhe, nëse ligji i brendshëm i palës së lartë kontraktuese, të lidhur me çështjen, lejon vetëm një shlyerje të pjesshme, nëse është e nevojshme, Gjykata do të sigurojë dëmshpërblim për palën e dëmtuar.”

A. Dëmi

26. Ankuesi kërkoi 13,332 euro (EUR) për sa i përket dëmit monetar, i cili ishte 7,332 euro për sa ka të bëjë me humbjen e interesit të shtuar, nëse do t’i kishte vendosur paratë në një depozitë kursimesh dhe 6,000 euro për sa ka të bëjë me humbjen e kontributit të pensionit. Më tej, ai kërkoi 9,000 euro për dëmin jomonetar.

27. Qeveria parashtrroi se ankuesi nuk dorëzoi një raport nga një ekspert në lidhje me llogaritjen e humbjeve nga interesi i shtuar dhe nga mungesa e pretenduar prej tij e të ardhurave të punës. Dëmi jomonetar ka të bëjë vetëm me periudhën deri më 1 janar 2006, për arsye se ai nuk ishte më në listën e pritjes së punëdhënësit pas kësaj date.

28. Gjykata vëren se ankuesi nxori disa shifra në lidhje me dëmin monetar, por verifikimi i tyre mbeti i paqartë dhe llogaritja e tyre linte vend për spekulime. Prandaj, për këtë pikë ajo nuk lëshon asnjë vendim. Sipas një vlerësimi të paanshëm, më tej Gjykata i akordon ankuesit 2,900 euro në lidhje me dëmin jomonetar, duke pasur parasysh zbatimin e vonuar të vendimit dhe shkeljet e gjetura.

B. Kostot dhe shpenzimet

29. Gjithashtu, ankuesi kërkoi 2,000 euro për kostot dhe shpenzimet e bëra në gjykatat vendase dhe 3,200 euro për shpenzimet e bëra në këtë Gjykatë.

30. Qeveria parashtrroi se kërkesat e ankuesit për kostot dhe shpenzimet ishin të pabaza, duke qenë se faturat që ai kishte paraqitur nuk ishin konform kërkesave ligjore vendase.

31. Duke pasur parasysh faktin se kjo ishte një çështje ligjore e mirorganizuar dhe se faktet e parashtruara ishin të drejtpërdrejta dhe në bazë të dokumenteve të paraqitura nga ankuesi, Gjykata e shikon të arsyeshme që t’i akordojë shumën prej 1,000 eurosh, duke mbuluar kostot për gjithçka.



C. Interes i papaguar

32. Gjykata e gjykon si të arsyeshme që norma e interesit të papaguar duhet të bazohet në normën marxhinale të huas së Bankës Qendrore Europiane, dhe në fund duhet t'i shtohen pikë trepërqindëshe.

PËR KËTO ARSYE, NË MËNYRË UNANIME GJYKATA

1. *Kundërshton* kërkesën e qeverisë për ta anuluar aplikimin nga lista;
2. *Arrin në përfundimin* se ka pasur një dhunim të neneve 6 § 1 dhe 13 të konventës në lidhje me zbatimin e vonuar të vendimit të Gjykatës së Lartë të datës 2 shkurt 2007;
3. *Arrin në përfundimin* se ka pasur shkelje të nenit 1 të protokollit nr. 1 të konventës;
4. *Arrin në përfundimin*:
 - a) se shteti përgjegjës duhet t'i paguajë aplikantit brenda tre muajve; shumat e mëposhtme, të cilat duhet të konvertohen në vlerën monetare të shtetit përgjegjës në normën e aplikueshme në datën e shlyerjes:
 - i) 2,900 (dy mijë e nëntë qind euro) EUR plus taksat që mund të vihen në ngarkesë, për sa ka të bëjë me dëmin jomonetar;
 - ii) 1,000 euro (një mijë euro) EUR për kostot dhe shpenzimet;
 - b) se nga moment i përfundimit të tre muajve të përmendur më sipër deri në momentin e shlyerjes, interesi i thjeshtë do të paguhet për shumat e mësipërme me një normë të njëjtë me normën marxhinale të huas të Bankës Qendrore Europiane gjatë periudhës së mospagesës plus tre për qind pikë.
5. *Kundërshton* pjesën tjetër të kërkesës së ankuesit për dëmshpërblim.
E hartuar në anglisht, me shkrim më 15 janar 2013, sipas rregullit 77 §§ 2 dhe 3 të rregullores së Gjykatës.

Fatoş Arac¹⁾
Zëvendëssekretar

George Nicolaou
President

SEKSIONI I KATËRT

ÇËSHTJA E TUSHAJ KUNDËR SHQIPËRISË (APLIKIMI NR. 13620/10)

VENDIM
STRASBURG
15 janar 2013

Në çështjen e Tushaj kundër Shqipërisë, Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut (seksioni i katërt), e mbledhur si një Komitet i përbërë nga:

George Nicolaou, *president*

Zdravka Kalaydjieva

Faris Vehabović, *gjyqtarë*

dhe Fatoş Arac¹⁾, *zëvendëssekretar i seksionit*

Pasi ka diskutuar me dyer të mbyllura më 11 dhjetor 2012,

Lëshon vendimin e mëposhtëm, i cili u miratua në po atë ditë:

PROCEDURA

1. Çështja filloi me një aplikim (nr. 13620/10) kundër Republikës së Shqipërisë paraqitur në Gjykatë sipas nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (konventa) nga një shtetas shqiptar, Z. Lek Tushaj (ankuesi), më 6 mars 2010.

2. Ankuesi u përfaqësua nga Znj. E. Kokona dhe Znj. E. Meli, avokate, të cilat e ushtrojnë aktivitetin e tyre në Tiranë. Qeveria shqiptare (qeveria) përfaqësohej nga agjenti i saj, Znj. L. Mandia e Zyrës së Avokatit të Shtetit.

3. Më 11 korrik 2011, aplikimi iu komunikua qeverisë.

FAKTET

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

4. Ankuesi ka lindur në vitin 1970 dhe jeton në Shqipëri.

A. Procedurat në lidhje me rikthimin e ankuesit në punë

5. Pas heqjes së ankuesit nga puna, më 19 janar 2007, Komisioni i Shërbimit Civil (KSHC) urdhëroi punëdhënësin e tij, zyrën e Kryeministrit, ta rikthenin atë në punë. Nuk u mor asnjë vendim për pagesën e pagave të prapambetura.

6. Më 14 dhjetor 2007, Gjykata e Lartë e kundërshtoi apelimin e punëdhënësit dhe vendimi i KSHC-së u bë i formës së prerë.

7. Më 27 shkurt 2008, u lëshua një urdhër gjyqësor për zbatim.

8. Më 28 mars 2008, u lëshua një urdhër punësimi nga Departamenti i Administratës Publike. Megjithatë, ankuesi u ndalua nga punëdhënësi i tij që të merrte funksionet e tij.

9. Më 12 prill, 28 maj dhe 15 korrik 2008, ankuesi i kërkoi punëdhënësit të tij të pajtohej me urdhrin e punësimit, por nuk mori përgjigje.

10. Më 15 maj dhe 25 qershor 2006, Zyra e Avokatit të Popullit (zyrtari për keqadministrimin) kërkoi informacion nga punëdhënësi i ankuesit mbi respektimin e urdhrin të punësimit, por nuk mori përgjigje.

11. Më 12 shkurt 2010, zyrtari për keqadministrimin i rekomandoi punëdhënësit të ankuesit të respektonte urdhrin e punësimit.

12. Më 20 prill 2010, ankuesi paraqiti dorëheqjen.

B. Procedurat në lidhje me pagesën e pagave të prapambetura

13. Në një datë të papërcaktuar në vitin 2009, duke pasur parasysh faktin se ankuesi nuk mundi të rifillonte punën e tij, ai kërkoi përpara gjykatës vendase të paguhej për pagat e prapambetura.

14. Me një vendim të formës së prerë, më 2 korrik 2009, Gjykata e Lartë përkrahu vendimin e gjykatës së ulët, duke e deklaruar çështjen jashtë juridiksionit, me pretendimin se padia duhej të ishte paraqitur në KSHC.

15. Më 10 mars 2010, në bazë të kërkesës së ankuesit, KSHC-ja e pranoi lutjen e tij. Ai urdhëroi punëdhënësin e tij të paguante pagat e prapambetura të ankuesit që nga 28 marsi 2008.

16. Rezulton se në mars 2010, ankuesit iu paguan pagat e prapambetura për periudhën midis 28 mars 2008 dhe 20 prill 2010, datë në të cilën ai dha dorëheqjen.

II. LIGJI VENDAS DHE PRAKTIKA PËRKATËSE

17. Ligji vendas dhe praktika përkatëse janë përshkruar në çështjet e *Qufaj CO. sh.p.k. kundër Shqipërisë* (nr. 54268/00, §§ 21-26, 18 nëntor 2004) dhe *Gjyli kundër Shqipërisë* (nr. 32907/07, §§19-28, 29 nëntor 2009).

LIGJI

I. PRETENDIMI PËR SHKELJE TË NENEVE 6 § 1 DHE 13 TË KONVENTËS DHE NENIT 1 I PROTOKOLLIT NR. 1 TË KONVENTËS

18. Ankuesi parashtori se moszbatimi i vendimit të KSHC-së i datës 19 janar 2007, siç u mbështet edhe nga vendimi i Gjykatës së Lartë, më 14 dhjetor 2007, shkelnin të drejtat e tij sipas



nenit 6 § 1 dhe 13 të konventës, si edhe të nenit 1 të protokollit nr. 1 të konventës, të cilët pohojnë si më poshtë:

Neni 6 § 1

“Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ... çdonjërit i jepet e drejta për t’u dëgjuar ... në mënyrë të drejtë ... nga një ... gjykatë”

Neni 13

“Çdonjëri, të drejtat dhe liritë e të cilit, siç parashtrohen në konventë, dhunohen, do të marrë një kompensim përpara një autoriteti kombëtar, pavarësisht faktit se dhunimi mund të jetë bërë nga persona, të cilët veprojnë nën një kompetencë zyrtare.”

Neni 1 i protokollit nr. 1

“Çdo individ human apo ligjor ka të drejtën të gëzojë pronat e tij. Asnjë nuk privohet nga pronat e tij përveçse kur ato janë në interesa publikë dhe subjekte të kushteve të parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të ligjit ndërkombëtar.

A. Pranueshmëria

1. Në lidhje me ankesën sipas nenit 1 të protokollit nr. 1 të konventës

19. Qeveria parashitroi faktin se ankuesit iu njoh e drejta për të marrë pagesën e pagës vetëm në mars 2010, dhe se kjo e drejtë nuk iu njoh nga vendimi i KSHC-së, i datës 19 janar 2007. Ata i kërkuan Gjykatës që ta kundërshtonte kërkesën e ankuesit në lidhje me pagesat e prapambetura të pagës për periudhën midis vitit 2007 dhe 2008, duke qenë se kjo kërkesë ishte e pabazë, dhe se një e drejtë e tillë nuk ishte pranuar nga gjykatat vendase.

20. Ankuesi pretendonte se e drejta për të marrë pagesën e pagave vinte nga vendimi i KSHC-së, i datës 19 janar 2007, vendim, i cili kërkonte që ai të rikthehej në punë. Edhe pse atij iu paguan me vonesë prapambetjet e pagave për periudhën midis 28 marsit 2008 dhe 20 prillit 2010, ankuesit nuk iu pagua asnjë pagë për periudhën midis 19 janarit 2007 dhe 28 marsit 2008.

21. Gjykata përsërit se një ankues mund të pretendojë se ka shkelje të nenit 1 të protokollit nr. 1 vetëm për sa ka të bëjë me vendimet që janë të dyshimta në lidhje me “pronat” e tij brenda interpretimit të këtij parashikimi. “Pronat” mund të jenë ose “prona ekzistuese” ose asete, duke përfshirë pretendimet, në lidhje me të cilat ankuesi mund të argumentojë se ai ose ajo ka të paktën “një pritshmëri legjitime” për të gëzuar efektivisht të drejtën e pronës (shiko *Gratzinger dhe Gratzingerova kundër Republikës Çeke* (vendim) [GJP], nr. 39794/98, § 69, GJEDNJ 2002-VII).

22. Në çështjen konkrete, Gjykata vëren se e drejta e ankuesit për t’u rikthyer në punë përfundimisht u mbështet nga Gjykata e Lartë më 14 dhjetor 2007. Pretendimi për shkelje të të drejtave të tij të konventës fillon prej kësaj date (në lidhje me këtë shiko *Gjyli*, cituar më sipër, § 33).

23. Më tej Gjykata vëren se gjykata vendase nuk mori një vendim mbi të drejtën e ankuesit për të marrë pagat e prapambetura, duke qenë se këto të drejta i ishin njohur në një pjesë më të veçantë procedurash, dhe vetëm për periudhën midis marsit 2008, e cila është edhe data e rikthimit të tij në punë dhe 20 prillit 2010, e cila është data e dorëheqjes së tij (shiko paragrafët 13-16 më sipër). Vetë ankuesi pranoi se pagat e prapambetura për periudhën e mësipërme i ishin paguar.

24. Në këto rrethana, Gjykata mendon se ankuesi nuk mund të pretendonte të ishte viktimë e një shkelje të të drejtave të konventës në lidhje me pretendimin për mosmarrjen e pagave të prapambetura për periudhën midis 19 janarit 2007 dhe 28 marsit 2008. Për këtë arsye ajo nuk e

pranon këtë ankesë si të papajtueshme *ratione personae* (për personin e përfshirë) me nenin 35 §§ 3 (a) dhe 4 të konventës.

2. Në lidhje me pjesën tjetër të ankesave sipas neneve 6 dhe 13 të konventës

25. Gjykata vëren se pjesa tjetër e ankesave të ankuesit nuk është e pabazë, sipas interpretimit të nenit 35 § 3 (a) të konventës. Më tej, ajo vëren se ato nuk janë të papranueshme. Prandaj ato duhet të deklarohen të pranueshme.

B. Përmbajtja e çështjes

26. Ankuesi parashtroi se vendimi i KSHC-së i datës 19 janar 2007, që ai të rikthehej në punë nuk u zbatua për një kohë të gjatë.

27. Qeveria pretendon se vendimi u zbatua më 28 mars 2008.

28. Gjykata vëren se vendimi i KSHC-së në lidhje me këtë çështje u bë i formës së prerë më 14 dhjetor 2007. Urdhri për punësim u lëshua më 28 mars 2008. Në lidhje me këtë situatë, ajo vëren se ndërsa autoritetet publike po ndërmerrnin hapat zyrtarë për ta zbatuar atë vendim, punëdhënësi i ankuesit praktikisht e ndaloi atë që të merrte funksionet e tij. Ky konstatim mbështetet edhe nga korrespondenca e ankuesit me autoritetet (shiko paragrafët 8-11 më sipër) dhe nga procedurat e tij në lidhje me pagesat e prapambetura të pagës. Qeveria nuk siguroi asnjë justifikim objektiv të çfarëdolloji në lidhje me këtë moszbatim.

29. Më tej, Gjykata rikujton se nuk ka asnjë kompensim efektiv nga autoritetet vendase për sa ka të bëjë me zbatimin e vonuar apo moszbatimin e një vendimi përfundimtar të gjykatës (shiko *Puto dhe të tjerët kundër Shqipërisë*, nr. 609/07, §§ 33-35, 20 korrik 2010; dhe *Gjyli*, cituar më sipër, §§ 55-60).

30. Në lidhje me çështjen ligjore në fjalë të mirorganizuar (*Qufaj Co. sh.p.k.*, cituar më sipër; *Gjyli*, cituar më sipër; dhe *Puto dhe të tjerët*, cituar më sipër), Gjykata konstaton se ka pasur një shkelje të nenit 6 § 1 të konventës në lidhje me moszbatimin e vendimit në favor të ankuesit dhe se ka pasur edhe një shkelje të nenit 13 të konventës për arsye se nuk ka pasur dëmshpërblim nga pala vendase për moszbatimin e vendimit.

II. ZBATIMI I NENIT 41 TË KONVENTËS

31. Neni 41 i konventës parashikon:

“Nëse Gjykata konstaton se ka pasur shkelje të konventës apo të protokolleve, dhe nëse ligji i brendshëm i palës së lartë kontraktuese në lidhje me çështjen bën të mundur vetëm një dëmshpërblim të pjesshëm, nëse është e nevojshme, Gjykata do të sigurojë dëmshpërblimin për palën e dëmtuar.”

A. Dëmi

32. Ankuesi kërkoi 14,000 euro (EUR) për dëmin monetar dhe 5,000 euro për dëmin jomonetar.

33. Qeveria i kontestoi kërkesat e ankuesit.

34. Gjykata nuk konstaton ndonjë lidhje rastësore midis shkeljeve të gjetura dhe pretendimit për dëm monetar. Për këtë arsye, ajo i kundërshton kërkesat. Nga ana tjetër, ajo i akordon ankuesit 1,300 euro për dëmin jomonetar.

B. Kostot dhe shpenzimet

35. Gjithashtu, ankuesi kërkoi 2,200 euro për dëmet dhe shpenzimet e shkaktuara përpara kësaj Gjykate.

36. Qeveria i kontestoi kërkesat e ankuesit.

37. Në bazë të dokumenteve të dorëzuara nga ankuesi dhe duke iu referuar faktit se kjo çështje ishte subjekt i një çështjeje ligjore të mirorganizuar dhe se faktet e parashtruara ishin të drejtpërdrejta, Gjykata e shikon të arsyeshme që të akordojë shumën prej 500 eurosh për të mbuluar kostot e gjithçkaje.

C. Interesi i papaguar

38. Gjykata e shikon të arsyeshme që norma e interesit të papaguar duhet të bazohet në



normën marxhinale të huas të Bankës Qendrore Europiane, së cilës duhet t'i shtohen edhe pikë trepërqindëshe.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA, NË MËNYRË UNANIME:

1. *I deklaron* ankesat e bazuara në nenet 6 § 1 dhe 13 të konventës të pranueshme dhe pjesën tjetër të kërkesës të papranueshme.

2. *Arrin në përfundimin* se ka pasur shkelje të neneve 6 § 1 dhe 13 të konventës për sa ka të bëjë me moszbatimin e vendimit final.

3. *Arrin në përfundimin:*

a) se shteti përgjegjës duhet t'i paguajë ankuesit, brenda tre muajve, shumat e mëposhtme të konvertuara në vlerën monetare të shtetit përgjegjës sipas normës në fuqi në datën e shlyerjes:

i) 1,300 euro (një mijë e tre qind euro), plus çdo taksë që mund të vihet në ngarkesë për sa ka të bëjë me dëmin jomonetar;

ii) 500 euro (pesë qind euro), plus çdo taksë që mund të vihet në ngarkesë, për sa ka të bëjë me kostot dhe shpenzimet;

b) se nga momenti i përfundimit të tre muajve të përmendur më sipër deri në momentin e shlyerjes interesi i thjeshtë do të paguhet për shumat e mësipërme me një normë të njëjtë me normën marxhinale të huas të Bankës Qendrore Europiane gjatë periudhës së mospagesës plus pikë trepërqindëshe.

4. Kundërshton pjesën tjetër të kërkesës së ankuesit për dëmshpërblim.

E hartuar në anglisht, me shkrim më 15 janar 2013, sipas rregullit 77 §§ 2 dhe 3 të rregullores së Gjykatës.

Fatoş Arac¹⁾
Zëvendësekreter

George Nicolaou
President

SEKSIONI I KATËRT

ÇËSHTJA “QAMA KUNDËR SHQIPËRISË DHE ITALISË” (ANKIMI NR. 4604/09)

VENDIM
STRASBURG
8 janar 2013

Në çështjen “Qama kundër Shqipërisë dhe Italisë”, Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut (seksioni i katërt), duke gjykuar si Dhomë e përbërë nga:

Ineta Ziemele, *president*

David Thór Björgvinsson

Guido Raimondi

Päivi Hirvelä

George Nicolaou

Ledi Bianku

Vincent A. De Gaetano, *gjykatës*

dhe Fatoş Arac¹⁾, *regjistruet i seksionit*,

pas shqyrtimit me dyer të mbyllura më 4 dhjetor 2012, shpall vendimin e mëposhtëm të miratuar në atë datë:

PROCEDURA

1. Çështja e ka zanafillën në ankimin (nr. 4604/09) kundër Republikës së Shqipërisë të depozituar në Gjykatë sipas nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore (konventa) nga shtetasi shqiptar, Z. Flamur Qama (ankuesi), më 23 dhjetor 2008.

2. Qeveria shqiptare (qeveria) u përfaqësua nga agjentja e atëhershme e saj, Znj. E. Hajro dhe më pas nga znj. L. Mandia nga Zyra e Avokatit të Shtetit. Qeveria italiane u përfaqësua nga bashkëagjenti i atëhershëm i saj, z. N. Lettieri dhe, më pas, nga znj. P. Accardo.

3. Ankuesi pretendonte, në veçanti, se ka pasur shkelje të neneve 6 § 1 dhe 8, si rezultat i dështimit nga ana e autoriteteve shqiptare dhe italiane për të siguruar të drejtën e kontaktit me djalin e tij në Itali.

4. Më 21 shtator 2009 ankimi iu njoftua qeverive të paditura. Gjithashtu, Gjykata vendosi të shqyrtonte pranueshmërinë e ankimit dhe meritat (themelin) e tij në të njëjtën kohë.

FAKTET

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

5. Ankuesi ka lindur më 1960 dhe jeton në Durrës. Ai ka një djalë, i cili ka lindur më 25 gusht 1994. Aktualisht djali është 18 vjeç.

6. Në shtator 1999 bashkëshortja e ndjerë e ankuesit, e cila vuante nga një sëmundje e rëndë, hyri në Itali në mënyrë të parregullt, së bashku me të birin, me qëllim që të merrte trajtim mjekësor. Në një datë të pacaktuar ankuesi u bashkua me bashkëshorten dhe djalin e tij në Itali.

7. Në një datë të pacaktuar në gusht ose shtator 2002, pas mosmarrëveshjeve me të afërmit e bashkëshortes, ankuesi u dëbua nga Italia, meqenëse nuk kishte leje qëndrimi. Bashkëshortja e tij dhe i biri, situata e të cilëve nuk ishte rregulluar akoma, vazhduan të qëndrojnë në Itali. Bashkëshortja e tij vdiq më 7 tetor 2002.

A. Procedurat e kujdestarisë në Itali

8. Më 17 tetor 2002, kunata e ankuesit, z., depozitoi një padi pranë Gjykatës për të Mitur në Ankona (gjykata italiane - *tribunale per i minorenni*) ku kërkonte kujdestarinë e djalit të ankuesit.

9. Më 30 dhjetor 2002 një raport i qendrës lokale të kujdesit lokal njoftonte se fëmija kishte frikë të kthehej dhe të jetonte me të atin për shkak të keqtrajtimit të tij ndaj nënës së ndjerë. Më tej, në raport thuhej se i ati e kishte braktisur të birin dhe bashkëshorten e tij pa i njoftuar në një kohë kur ata kishin shumë nevojë për të.

10. Më 4 qershor 2003 gjykata italiane pranoi kërkesën e z., Kjo gjykatë i besoi asaj kujdestarinë e djalit të ankuesit, nën mbikëqyrjen e shërbimit social të qytetit të Senigallias (*affida il minore alla zia .., sotto la vigilanza del Servizio Sociale del Comune di Senigallia...*). Më tej ajo caktoi kryetarin e bashkisë si kujdestari i përkohshëm i fëmijës (*tutore provvisorio*). Gjykata pezulloi të drejtat prindërore të prindërve (*dichiara sospesa la potestà dei genitori*) me argumentin se ato kishin lejuar fëmijën të largohej nga Shqipëria pa zgjidhur vështirësitë serioze që do të ndeshte djali i tyre më pas. Më tej, gjykata ndaloi largimin e fëmijës nga territori italian. Ajo caktoi Shërbimin Social Ndërkombëtar (ISS - një OJQ) të kryente hetime në lidhje me situatën familjare të ankuesit. Asnjë parashikim nuk u bë në lidhje me të drejtën e ankuesit për të vizituar apo kontaktuar me të birin.

11. Më 25 shtator 2003, pas përpjekjeve për të kontaktuar me ankuesin, ISS-ja njoftoi gjykatën Italiane se ai refuzoi të fliste me ta. Ai thjesht kërkoi që fëmija t'i kthehej atij. Pas kontakteve me fqinjët e tij, ISS-ja deklaroi se ankuesi ishte rimartuar dhe bashkëshortja e tij priste një fëmijë. Duke qenë i papunë, ai jetonte me të ardhurat e bashkëshortes.

12. Më 22 mars 2004 shërbimi social në Itali paraqiti pranë gjykatës të dhënat më të fundit për djalin e ankuesit. Deri në atë kohë, statusi i djalit në Itali ishte rregulluar dhe situata e tij dukej se ishte ekuilibruar.



13. Më 4 prill 2005, Ministria e Drejtësisë Italiane njoftoi ankuesin mbi dispozitat në fuqi të vendimit të datës 4 qershor 2003 dhe i paraqiti atij të dhënat më të fundit të datës 6 nëntor 2004 për të birin. Ankuesi u informua më tej mbi mundësinë e tij për të depozituar një ankesë kundër këtij vendimi pranë gjykatës italiane, me anë të një avokati.

14. Më 21 dhjetor 2005 letra është përkthyer dhe noterizuar, në praninë e ankuesit, nga një noter shqiptar.

15. Në një deklaratë të datës 15 janar 2007 para gjykatës italiane, fëmija i ankuesit u shpreh se nuk kishte qenë në kontakt me ankuesin apo ta ketë takuar atë prej disa vitesh. Ai nuk dëshironte të fliste me ankuesin në telefon, pasi pretendonte se i ati e kishte keqtrajtuar në të kaluarën.

16. Më 7 dhjetor 2007 djali i ankuesit konfirmoi para gjykatës italiane deklaratat e bëra prej tij më 15 janar 2007.

B. Përpyekjet e ankuesit për të kontaktuar me djalin e tij në Itali

17. Në një letër me datë të pacaktuar, e cila është dërguar rekomande dhe është regjistruar në sekretarinë e gjykatës italiane më 22 janar 2007, ankuesi deklaronte se të afërmit e bashkëshortes kishin rrëmbyer të birin dhe ai nuk kishte kontakte me të. Ai deklaronte se kujdestaria e të birit i ishte besuar tezes së tij pa pëlqimin paraprak të ankuesit dhe se ai kërkonte ndihmën e gjykatës italiane për të rivendosur kontaktin me djalin e tij.

18. Në një letër, e dërguar rekomande dhe e regjistruar në sekretarinë e gjykatës italiane më 22 janar 2007 dhe nënshkruar nga avokati shqiptar i ankuesit, ankuesi kërkonte zbatimin nga ana e autoriteteve italiane të së drejtës së tij të aksesit ndaj të birit sipas vendimit të datës 30 qershor 2006 të Gjykatës së Rrethit Durrës. Meqenëse nuk mund të udhëtonte për në Itali, ai i kërkonte gjykatës italiane të lejonte të birin të udhëtonte në Shqipëri, siç tregohet në vendimin e gjykatës shqiptare. Ai deklaronte se fitonte të ardhura mujore prej 700 eurosh, banonte në një apartament me sipërfaqe 70 m² që ofronte akomodimin e duhur, kishte dëshmi të pastër penaliteti, ndjenjat dhe afekcioni për djalin e tij as nuk kishin ndryshuar dhe as nuk kishin reshtur dhe përpyekjet e tij për të kontaktuar me të birin kishin ndeshur me refuzimin këmbëngulës të tezes së fëmijës. Ankuesi deklaronte më tej se kërkesa e tij synonte ushtrimin e së drejtës së tij për të kontaktuar me të birin, siç është caktuar nga gjykata shqiptare më 30 qershor 2006, duke përfshirë kontaktin telefonik pa pengesa me të birin, apo në çdo mënyrë tjetër që gjykata italiane e çmonte të arsyeshme. Ai kërkonte më tej që kujdestaria e të birit t'i besohet shërbimeve sociale italiane. Megjithatë, ai nuk kërkoi kthimin e përhershëm të djalit të tij në Shqipëri. Asnjë prokurë nuk është paraqitur në sekretarinë e gjykatës italiane.

19. Duket se më 15 nëntor 2007, duke u bazuar në Konventën e Hagës mbi aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijëve (shih paragrafët 36-43 më poshtë), ankuesi i ka kërkuar Ministrisë Italiane të Drejtësisë fillimin e procedurave për vlefshmërinë e vendimit të gjykatës shqiptare të datës 30 qershor 2006 dhe zbatimin e të drejtës së tij për të kontaktuar me të birin.

C. Procedurat në lidhje me kthimin dhe marrjen e djalit të ankuesit në Shqipëri

20. Më 27 nëntor 2002 ankuesi depozitoi një padi penale pranë Gjykatës së Rrethit, Durrës (Gjykata e Rrethit) sipas nenit 127 të Kodit Penal (KP) dhe nenit 59 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), ku kërkonte kthimin e djalit të tij, i cili sipas tij ishte marrë padrejtësisht në Itali.

21. Më 13 janar 2003 Gjykata e Rrethit vendosi pushimin e çështjes me argumentin se padia e ankuesit ishte e pabazuar në prova.

22. Më 7 tetor 2003 ankuesi depozitoi një padi tjetër pranë Gjykatës së Rrethit ku akuzonte të afërmit e bashkëshortes së tij për marrjen e padrejtë të të birit në kundërshtim me nenin 127 të KP-së.

23. Më 29 dhjetor 2004 Gjykata e Rrethit shpalli fajtor të afërmit e bashkëshortes së ankuesit sipas akuzës dhe i dënoi ato me gjobë, duke përfshirë z,. Ky vendim u la në fuqi nga Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme më 2005-ën dhe 2007-ën vetëm në lidhje me z,. Procedimet gjyqësore u bënë në mungesë të z,. që me sa duket u përfaqësua nga një avokat. Asnjë referencë nuk

u bë për vendimin e gjykatës të datës 4 qershor 2003 (shih paragrafin 10 më lart).

24. Më 11 prill 2008, pas një padie tjetër të depozituar nga ankuesi sipas nenit 127 të Kodit Penal dhe nenit 59 të KPP-së, Gjykata e Rrethit e rrëzoi akuzën. Pas njoftimit të Z., nga Ministria Italiane e Drejtësisë mbi procedimet gjyqësore, gjykata konstatoi se ajo ishte gjykuar një herë dhe shpallur fajtores për të njëjtën shkelje, në lidhje me të cilën ajo kishte përfituar nga një amnisti (shih paragrafin 23 më lart). Bazuar në vendimin e gjykatës të datës 4 qershor 2003, Gjykata e Rrethit vendosi se Z., nuk ishte përfshirë në asnjë largim të padrejtë të fëmijës.

25. Megjithatë, më 3 mars 2009 Gjykata e Rrethit shpalli Z., fajtores për veprën penale të mbajtjes së padrejtë të fëmijës në përputhje me nenin 127 të KP-së dhe e dënoi atë me gjobë. Sipas vendimit, megjithëse Z., kthehej çdo verë në Shqipëri, ajo refuzonte qëllimisht të sillte djalin e ankuesit, në kundërshtim me vendimin e gjykatës të datës 30 qershor 2006 (shih paragrafin 26 më lart), me qëllim që të shkëpuste plotësisht lidhjet ndërmjet ankuesit dhe djalit të tij. Procedimet gjyqësore u bënë në mungesë të Z., e cila u përfaqësua nga një avokat i zgjedhur prej saj.

D. Procedurat në lidhje me vendosjen e kontaktit me djalin në Shqipëri

26. Më 30 qershor 2006, pas padisë civile të ankuesit, Gjykata e Rrethit pranoi kërkesën e ankuesit për të takuar të birin. Ajo urdhëroi Z., të lejonte ankuesin të takonte të birin të paktën dy herë në vit, ndërmjet datave 1 dhe 15 gusht dhe ndërmjet datave 27 dhjetor dhe 6 janar. Procedurat u bënë në mungesë të Z., e cila ishte informuar në lidhje me to nëpërmjet njoftimit publik. Asnjë referencë nuk u bë në lidhje me vendimin e gjykatës italiane të datës 4 qershor 2003 (shih paragrafin 10 më lart). Pjesët përkatëse të vendimit parashikojnë si më poshtë:

“Paditësi është njoftuar se djali trajtohet mirë nga tezja, e paditura [në këtë set procedimesh gjyqësore]; fëmija ndjek shkollën dhe ka marrë rezultate të mira. I motivuar nga ndjenja prindërore, ai fillimisht dhe pa qëllim depozitoi padinë ku kërkonte kthimin e djalit të tij nga e paditura.

Gjatë procedimeve gjyqësore, duke i dhënë përparësi interesit të fëmijës, ai kufizoi padinë e tij, duke i kërkuar gjykatës të vendoste mbi të drejtën për të pasur kontakte me të birin. Ai bëri të ditur para gjykatës se fitonte pagë të mirë, kishte krijuar familje të re dhe kishte shtëpi dhe një fëmijë nga martesë e tij e dytë.

Sipas nenit 155 të Kodit të Familjes, gjykata kërkoi mendimin e punonjësit social. Duke pasur parasysh nenin 155 të Kodit të Familjes, padia e paditësit duhet të pranohet dhe e drejta e tij për të takuar të birin, për të cilin aktualisht kujdeset tezja e tij, duhet të zbatohet gjatë pushimeve shkollore.”

27. Më 27 nëntor 2006 u nxor një urdhër ekzekutimi në lidhje me vendimin e Gjykatës së Rrethit. Zbatimi i tij iu caktua zyrës përmbartimore lokale.

28. Më 24 korrik 2008 Gjykata e Rrethit rrëzoi padinë e ankuesit për njohjen e vendimeve të datave 29 dhjetor 2004 dhe 30 qershor 2006 sipas Konventës së Hagës mbi Aspektet Civile të Rrëmbimit Ndërkombëtar të Fëmijëve dhe Konventës së Hagës për Juridiksionin me argumentin se këto vendime ishin drejtpërdrejt të zbatueshme në Shqipëri.

29. Më 3 mars 2009 Gjykata e Rrethit urdhëroi Z., të lejonte ankuesin të takonte të birin. Sipas këtij vendimi, ankuesit nuk mund t'i mohohet një e drejtë e tillë për sa kohë që nuk i është revokuar përgjegjësia e tij prindërore. Megjithatë, vendimi më tej shprehte se ankuesi duhet të gjejë mjetet ligjore për të siguruar zbatimin e këtij vendimi, ku gjykata nuk mund t'i siguronte atij marrjen e vizës për në Itali dhe mundësinë të shkonte atje. Gjykata pushoi procedimet ligjore në lidhje me pretendimin e ankuesit për kthimin e të birit, ku edhe vetë ankuesi e tërhoqi këtë pretendim.

E. Korrespondenca e ankuesit me institucionet shqiptare

30. Nga viti 2003 deri në vitin 2009 ankuesi kërkoi ndihmën e autoriteteve përkatëse shqiptare (Ministritë së Brendshme, Ministritë së Drejtësisë, Ministritë së Punëve të Jashtme, Avokatit të Popullit, zyrës së Kryeministrit, zyrës së Presidentit) për zbatimin e të drejtës së tij të kontaktit me të birin.



31. Më 6 korrik 2005 zyra e Prokurorit të Përgjithshëm kërkoi ndihmën e Zyrës Ndërlidhëse Policore Italiane të Interforcës në Shqipëri (*Interforze*), në lidhje me statusin e djalit të ankuesit në Itali. Më 8 korrik 2005 Interforze njoftoi zyrën e Prokurorit të Përgjithshëm mbi vendimin e gjykatës italiane të vitit 2003.

32. Në shtator 2006 Ministria e Brendshme deklaroi se ishte jashtë juridiksionit të saj të siguronte kthimin e djalit në Shqipëri ose përmbushjen e kërkesave të tjera të bëra nga ankuesi për sa kohë që kujdestaria e djalit i është besuar Z., bazuar në vendimin e gjykatës italiane.

33. Në vitin 2002, 2006 dhe 2008 Ministria e Punëve të Jashtme informoi ankuesin se i është kërkuar konsullatës shqiptare në Milano të ndjekë çështjen e tij.

34. Më 29 janar 2009, pas kërkesës për informacion nga zyra e Avokatit të Popullit mbi çështjen e ankuesit, Ministria e Drejtësisë u përgjigj, në lidhje me rastin në fjalë, si më poshtë:

“Ministria e Drejtësisë ka pasur kontakte të vazhdueshme me Z. Qama dhe ka shprehur dëshirën e saj për ta zgjidhur këtë problem. Ai i ka kërkuar Ministrisë së Drejtësisë zbatimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Durrës të datës 30 qershor 2006. Ministria e Drejtësisë, së bashku me Drejtorinë e Zyrës së Përmbartimit, ka informuar Z. Qama në mënyrë të përsëritur se nuk ekziston baza ligjore për t’i kërkuar autoriteteve italiane njohjen dhe zbatimin e një vendimi të gjykatës civile shqiptare, meqenëse Shqipëria nuk është palë e asnjë marrëveshjeje ndërkombëtare që rregullon njohjen dhe zbatimin e vendimeve të gjykatës civile shqiptare... Ministria e Drejtësisë e ka orientuar Z. Qama që t’i drejtohet Ministrisë së Punëve të Jashtme.”

35. Më 16 shkurt 2009 ankuesi është njoftuar mbi përgjigjen e Ministrisë së Drejtësisë.

II. E DREJTA PËRKATËSE NDËRKOMBËTARE

A. Konventa e datës 25 tetor 1980 mbi Aspektet Civile të Rrëmbimit Ndërkombëtar të Fëmijëve (Konventa e Hagës mbi Aspektet Civile të Rrëmbimit Ndërkombëtar të Fëmijëve)

36. Konventa e Hagës mbi Aspektet Civile të Rrëmbimit Ndërkombëtar të Fëmijëve hyri në fuqi në lidhje me Shqipërinë më 1 gusht 2007 dhe në lidhje me Italinë më 1 maj 1995. Sipas nenit 1, objektet e saj janë të dyfishta, përkatësisht:

a) të sigurojë kthimin e menjëhershëm të fëmijëve që largohen apo mbahen pa të drejtë në shtetin kontraktues; dhe

b) të sigurojë që të drejtat e kujdestarisë dhe të kontaktit sipas ligjit të një shteti kontraktues të respektohen efektivisht në shtetet e tjera kontraktuese.”

37. Sipas nenit 5, “të drejtat e kujdestarisë” do të përfshijnë të drejtat që lidhen me kujdesin e fëmijës dhe, në veçanti, të drejtën për të përcaktuar vendbanimin e fëmijës dhe “të drejtat e aksesit” do të përfshijnë të drejtën për të marrë një fëmijë për një periudhë të kufizuar në një vend tjetër nga vendbanimi i tij i zakonshëm.

38. Detyrat sipas Konventës së Hagës mbi Aspektet Civile të Rrëmbimit Ndërkombëtar të Fëmijëve plotësohen nga një autoritet qendror në përputhje me nenin 6 të saj. Ministria e Drejtësisë, Departamenti i të Miturve dhe e Drejta Familjare, është caktuar si autoriteti qendror për Shqipërinë dhe Ministria e Drejtësisë, Departamenti i Drejtësisë për të Miturit (*Dipartimento per la Giustizia Minorile*) është autoriteti qendror italian.

39. Sipas nenit 7, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo me anë të një ndërmjetësi, autoriteti qendror duhet të marrë masat e mëposhtme për të arritur objektivat e Konventës së Hagës mbi Aspektet Civile të Rrëmbimit Ndërkombëtar të Fëmijëve:

a) për të zbuluar vendndodhjen e një fëmije, i cili është larguar apo mbajtur pa të drejtë;

b) për të parandaluar dëmtimin e mëtejshëm ndaj fëmijës ose paragjykimin te palët e interesuara, duke marrë ose bërë që të merren masa të përkohshme;

c) për të siguruar kthimin e vullnetshëm të fëmijës ose për të arritur një zgjidhje paqësore të çështjeve;

d) për të shkëmbyer, aty ku duhet, informacion në lidhje me prejardhjen sociale të fëmijës;

e) për të siguruar informacion të karakterit të përgjithshëm sipas ligjit të shtetit të tyre, në lidhje me zbatimin e konventës;

f) për të filluar apo lehtësuar procedimin gjyqësor ose administrativ, me qëllim kthimin e fëmijës dhe në rastin e duhur, për të marrë masat për organizimin ose sigurimin e ushtrimit efektiv të të drejtave të kontaktit;

g) kur e kërkojnë rrethanat, të sigurojnë ose të lehtësojnë sigurimin e konsulencës dhe asistencës ligjore, duke përfshirë pjesëmarrjen e konsulentëve ligjorë;

h) të marrin masat e nevojshme administrative, për të siguruar kthimin e sigurt të fëmijës;

i) të informojnë njëri-tjetrin në lidhje me funksionimin e kësaj konvente dhe sa të jetë e mundur, të eliminojnë pengesat ndaj zbatimit të saj.”

40. Neni 8 njuh të drejtën e personit për të kërkuar kthimin e fëmijës, i cili është larguar apo mbajtur në shkelje të të drejtave të kujdestarisë, duke iu drejtuar autoritetit qendror të vendbanimit të zakonshëm të fëmijës ose të një shteti tjetër kontraktues.

41. Neni 21 njuh të drejtën e personit për të kërkuar ushtrimin efektiv të të drejtave të tij të kontaktit në të njëjtën mënyrë, siç bëhet kërkesa për kthimin e fëmijës. Ky nen parashikon:

“Një kërkesë për marrjen e masave për organizimin ose sigurimin e ushtrimit efektiv të të drejtave të kontaktit, mund t’u paraqitet autoriteteve qendrore të shteteve kontraktuese, në të njëjtën mënyrë siç bëhet kërkesa për kthimin e fëmijës.

Autoritetet qendrore janë të detyruara nga detyrimet e bashkëpunimit, të cilat përcaktohen në nenin 7, të nxisin gëzimin paqësor të të drejtave të kontaktit dhe plotësimin e kushteve në të cilat mund të jetë objekt ushtrimi i këtyre të drejtave. Autoritetet qendrore do të ndërmarrin hapa për të shmangur, sa më shumë që të jetë e mundur, pengesat ndaj ushtrimit të këtyre të drejtave.

Autoritetet qendrore, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë, apo me anë të ndërmjetësve, mund të iniciojnë ose të ndihmojnë në fillimin e procedimit, me qëllim organizimin ose mbrojtjen e këtyre të drejtave dhe sigurimin e respektimit të kushteve ndaj të cilave mund të jetë objekt ushtrimi i këtyre të drejtave.”

42. Në lidhje me nenin 21, raporti shpjegues i Znj. Elisa Perez-Vera mbi hartimin e Konventës së Hagës mbi Aspektet Civile të Rrëmbimit Ndërkombëtar të Fëmijëve, që gjendet në adresën <http://www.hcch.net/upload/exp128.pdf>, në lidhje me këtë çështje, shpreh si më poshtë:

“... duhet të njihet se Konventa nuk kërkon të rregullojë të drejtat e kontaktit në mënyrë shteruese; pa dyshim kjo do të çonte përtej fushës së objektivave të konventës. Me të vërtetë, nëse vëmendja që i është kushtuar të drejtave të kontaktit rezulton nga besimi se këto të drejta janë rrjedhim logjik normal i të drejtave të kujdestarisë, do të mjaftonte në nivelin e konventës thjesht sigurimi i bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve qendrore në lidhje me organizimin ose mbrojtjen e ushtrimit aktual të këtyre të drejtave.”

B. Konventa e datës 19 tetor 1996 mbi juridiksionin, e drejta e zbatueshme, njohja, zbatimi dhe bashkëpunimi në lidhje me përgjegjësinë prindërore dhe masat për mbrojtjen e fëmijëve (Konventa e Hagës mbi Juridiksionin)

43. Konventa e Hagës mbi Juridiksionin hyri në fuqi në lidhje me Shqipërinë më 1 prill 2007. Italia nënshkroi Konventën e Hagës mbi Juridiksionin më 1 prill 2003, për të cilën asnjë ratifikim nuk është bërë deri më sot. Qëllimi i saj është përcaktimi i dispozitave të përbashkëta në lidhje me juridiksionin, të drejtën e zbatueshme, njohjen dhe zbatimin e masave për mbrojtjen e fëmijëve.

C. Këshilli i Konventës Europiane mbi Kontaktin në Lidhje me Fëmijët (Konventa e Kontaktit – CETS nr. 192)

44. Konventa e kontaktit hyri në fuqi në lidhje me Shqipërinë më 1 shtator 2005. Italia nënshkroi konventën e kontaktit më 15 maj 2005, për të cilën asnjë ratifikim nuk është bërë deri më sot. Objekti i saj është përcaktimi i parimeve të përgjithshme për zbatimin e vendimeve për kontaktin, për të vendosur masat e duhura mbrojtëse dhe garancitë që sigurojnë ushtrimin e duhur të



kontaktit dhe kthimin e menjëhershëm të fëmijëve në fund të periudhës së kontaktit dhe vendosjen e bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve qendrore, autoriteteve gjyqësore dhe organeve të tjera, me qëllim që të nxisin dhe përmirësojnë kontaktin ndërmjet fëmijëve dhe prindërve të tyre, si dhe personave të tjerë që kanë lidhje familjare me fëmijët.

III. E DREJTA PËRKATËSE E BRENDSHME

A. E drejta e brendshme shqiptare

1. Kushtetuta e Shqipërisë

45. Neni 122 parashikon se “një marrëveshje ndërkombëtare, e cila është ratifikuar, përbën pjesë të sistemit të brendshëm juridik...”. Një marrëveshje e tillë ndërkombëtare është drejtpërdrejt e zbatueshme dhe ka epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të.

46. Neni 142§3 parashikon se “Organet e shtetit janë të detyruara të ekzekutojnë vendimet gjyqësore.”

2. Kodi i Familjes

47. Neni 218 i Kodit të Familjes parashikon se “prindërit mund të kërkojnë nga gjykata kthimin e fëmijës së tyre të mitur, kur nuk jeton pranë tyre ose mbahet pa të drejtë nga persona të tjerë.”

3. Kodi Penal

48. Neni 127 i KP-së sanksionon marrjen e padrejtë të fëmijës prej, *ndër të tjera*, personit që ushtron autoritetin prindëror, si kundërvajtje penale që dënohet me gjobë ose me burgim deri në gjashtë muaj.

4. Kodi i Procedurës Penale

49. Neni 59 i KPP-së përcakton se viktima (*i dëmtuari akuzues*) mund të paraqesë kërkesë për ndjekje penale në gjykatë dhe të kërkojë dëmshpërblim nga individit që ka kryer një prej kundërvajtjeve të referuara në lidhje me të.

50. Neni 467 i KPP-së përcakton se vendimet e gjykatës që përmbajnë dënimin me gjobë ekzekutohen nga zyra e përmbarimit.

B. E drejta e brendshme italiane

1. Kodi Civil

51. Neni 330 i Kodit Civil parashikon:

“Gjykata mund t’i deklarojë të hequra të drejtat prindërore nëse prindërit nuk kryejnë ose neglizhojnë detyrimet e qenësishme në rolin e tyre prindëror apo abuzojnë me kompetencat në lidhje me to, duke i shkaktuar fëmijës dëme serioze.

Në një rast të tillë, nëse ekzistojnë argumente serioze për të vepruar në këtë mënyrë, gjykata mund të urdhërojë marrjen e fëmijës nga familja.”

52. Neni 332 i Kodit Civil parashikon:

“Gjykatësi mund të rivendosë autoritetin prindëror kur pushojnë së ekzistuari arsyet që justifikojnë heqjen e këtij autoriteti dhe nuk përbëjnë rrezik për fëmijën.”

53. Ligji nr. 149 i datës 28 mars 2001 ka ndryshuar disa dispozita të librit I, pjesa VIII e Kodit Civil dhe ligji nr. 184/1983. Neni 333 i Kodit Civil, i ndryshuar nga seksioni 37(2) i ligjit nr. 149/2001 parashikon:

Kur sjellja e njërit apo të dy prindërve nuk është e tillë që të çojë në heqjen e të drejtave prindërore sipas nenit 330, por gjithsesi është e dëmshme për fëmijën, gjykata mund të miratojë çdo masë që është e përshtatshme në këto rrethana dhe madje mund të urdhërojë marrjen e fëmijës nga familja e tij apo largimin e prindit apo partnerit që ka keqtrajtuar apo abuzuar me fëmijën.

Këto masa mund të revokohen në çdo moment.”

54. Neni 336 i Kodit Civil, i ndryshuar nga seksioni 37(3) i të njëjtit ligj, parashikon:

Masat e paraqitura në nenet e mësipërme miratohen pas kërkesës së bërë nga prindi tjetër, një anëtar i familjes apo prokurori dhe, kur vendimet e mëparshme revokohen, edhe nga prindi i

interesuar. Gjykata shqyrton çështjen me dyer të mbyllura dhe jep një vendim të arsyetuar pasi ka grumbulluar informacionin e duhur dhe ka dëgjuar përfaqësuesit e zyrës së prokurorit. Nëse masa kërkohet kundër njërit prej prindërve, ky prind duhet të dëgjohet. Në raste të jashtëzakonshme, gjykata mund të miratojë, edhe me propozimin e saj, masa të përkohshme në interes të fëmijës.

Në lidhje me vendimet e referuara në paragrafët e mësipërm, prindërit dhe fëmija përfaqësohen nga një avokat, i paguar nga shteti në rastet e parashikuara me ligj.”

55. Neni 337 i Kodit Civil parashikon:

“Gjykatësi i kujdestarisë mbikëqyr përputhjen me kushtet e caktuara nga gjykata për ushtrimin e autoritetit prindëror dhe për administrimin e pasurisë.”

56. Vendimet e gjykatave të miturve të marra në përputhje me nenet 330 dhe 333 të Kodit Civil kthehen në procedime ligjore të pakundërshtueshme (*volontario giurisdizione*). Ato nuk janë vendime të formës së prerë dhe prandaj mund të revokohen në çdo moment. Nuk lejohet ankimi kundër këtyre vendimeve, por çdo palë e interesuar mund të depozitojë kërkesë pranë Gjykatës së Apelit për rishikimin e situatës që mund të çojë në vendimin përkatës.

2. Kodi i Procedurës Civile

57. Neni 125 i Kodit të Procedurës Civile parashikon si më poshtë:

“Përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj, një deklaratë, pretendim, kërkesë, kundërkërkesë apo urdhër duhet të tregojë emrin e gjykatës së cilës i drejtohet [detajet e plota të] palëve, objektin dhe arsyet e kërkesës, parashtrimet ose pretendimet dhe origjinali, si dhe kopjet që do të dorëzohen, duhet të nënshkruhen nga pala, nëse kjo e fundit vendos të paraqitet në gjykatë personalisht apo të përfaqësohet nga avokati.”

E DREJTA

1. SHKELJA E PRETENDUAR E NENIT 8 TË KONVENTËS

58. Ankuesi u ankua se autoritetet shqiptare dhe italiane nuk i kanë siguruar të drejtën e kontaktit me djalin e tij në shkëlje të nenit 6§1 dhe 8 të konventës.

59. Si gjykatës i karakterizimit që jepet me ligj për faktet e çështjes, Gjykata e konsideron me vend shqyrtimin e ankesave të ankuesit vetëm sipas nenit 8 të konventës. Ndërkohë që neni nuk përmban kërkesa eksplicite procedurale, ai kërkon që procesi i vendimmarrjes që çon në masat e ndërhyrjes të jetë i drejtë dhe t’i sigurohet respekti i duhur i interesave të mbrojtura nga ky nen (shih *Sneerson* dhe *Kampanella v. Italisë*, nr. 14737/09, § 56, 12 korrik 2011).

60. Neni 8 i konventës parashikon si më poshtë:

“1. Çdo person ka të drejtë që t’i respektohet jeta e tij private dhe familjare, vendbanimi dhe korrespondenca e tij.

2. Autoriteti publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, vetëm në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur në një shoqëri demokratike, kjo masë është e domosdoshme për sigurimin kombëtar, për sigurimin publik, për mirëqenien ekonomike të vendit, për mbrojtjen e rendit ose për parandalimin e veprave penale, për mbrojtjen e shëndetit ose të moralit ose për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive të tjerëve.”

A. Pranueshmëria

1. Në lidhje me Italinë

61. Qeveria italiane argumentoi se ankuesi nuk kishte shteruar mjetet e brendshme ligjore. Së pari, ai duhej të kishte depozituar një padi për pavlefshmërinë ose apelimin kundër vendimit të gjykatës italiane të datës 4 qershor 2003 në përputhje me nenin 125 të Kodit të Procedurës Civile dhe nenet 332, 333 dhe 336 të Kodit Civil. Së dyti, për sa i përket ankesës së ankuesit për refuzimin e kujdestarisë ose refuzimin e djalit të tij për të kontaktuar me të, ai duhej të kishte depozituar padi civile pranë gjykatësit të kujdestarisë në përputhje me nenin 337 të Kodit Civil.

62. Ankuesi nuk ka bërë asnjë koment.

63. Një ankues duhet të veprojë në përputhje me rregullat dhe procedurat e zbatueshme të së



drejtës së brendshme, mungesa e të cilave në depozitim e kërkesës pranë Gjykatës mund të çojë në pavlefshmërinë e kushtit të përcaktuar në nenin 35 (*Ben Salah Adraqui dhe Dhaima v. Spanjës* (dec.), nr. 45023/98, 27 prill 2000). Në rastin në fjalë, Gjykata vlerëson se letrat e ankuesit të datave 22 janar dhe 22 shkurt 2007 nuk përbëjnë padi ligjore që kërkon pavlefshmërinë e vendimit të gjykatës italiane të datës 4 qershor 2003 ose apelimin kundër këtij vendimi. Për më tepër, këto shkresa nuk kanë përmbushur kërkesat e të drejtës së brendshme, veçanërisht nenin 125 të Kodit Italian të Procedurës Civile. Ato ishin nënshkruar nga një avokat shqiptar, i cili nuk duket të ketë pasur prokurë të lëshuar nga ankuesi (shih paragrafin 18 më lart.)

64. Në këto rrethana, ankimi i ankuesit kundër Italisë duhet të rrëzohet për mosshkrimin e mjeteve të brendshme ligjore në përputhje me nenin 35 §§ 1 dhe 4 të konventës. Megjithatë, Gjykata vëren se nuk ka asnjë pengesë për ankuesin që të përfitojë nga mjetet ligjore sipas të drejtës italiane, duke pasur parasysh faktin se vendimet e gjykatave për të mitur në Itali nuk janë përfundimtare dhe mund të revokohen në çdo kohë (shih paragrafin 56 më lart).

2. Në lidhje me Shqipërinë

a) Përputhja me rregullin gjashtëmujor

65. Qeveria shqiptare argumentoi se kërkesa ishte parashtruar jashtë afatit, ku vendimi i fundit është marrë më 30 qershor 2006.

66. Ankuesi nuk bëri asnjë koment.

67. Sipas nenit 35 § 1 të konventës “Gjykata mund të trajtojë vetëm çështje... brenda një periudhe prej gjashtë muajsh nga data në të cilën është marrë vendimi përfundimtar.” Rregulli gjashtëmujor nuk zbatohet për situatat që çojnë në vazhdimin e shkeljes së të drejtave të konventës (shih, *ndër të tjera, Iordache v. Rumanisë*, nr. 6817/02, § 50, 14 tetor 2008).

68. Në rastin në fjalë, ankuesi akoma kërkon zbatimin e të drejtës së tij për të kontaktuar me të birin, siç njihet nga gjykata shqiptare. Ndërmjet viteve 2006 dhe 2009 ai ka kërkuar në mënyrë të përsëritur zbatimin e vendimit të datës 30 qershor 2006, duke renditur ndihmën e qeverisë kompetente dhe institucioneve të tjera (shih paragrafët 32-35 më lart). Sa më lart dhe duke pasur parasysh rrethanat e veçanta të këtij rasti, Gjykata vlerëson se nuk lind asnjë problem në lidhje me përputhjen me afatin gjashtëmujor dhe, për rrjedhojë, refuzon kundërshtimin e qeverisë.

b) Përputhja me kërkesën për shterimin e mjeteve të brendshme ligjore

69. Qeveria shqiptare argumentoi se ankuesi nuk ka shteruar mjetet e brendshme ligjore. Ai nuk ka depozituar padi në përputhje me nenin 59 të Kodit të Procedurës Penale (KPP) apo shteruar mjetet ligjore siç kërkohet sipas Konventës së Kontaktit dhe Konventës së Hagës mbi Aspektet Civile të Rrëmbimit Ndërkombëtar të Fëmijëve.

70. Ankuesi nuk bëri asnjë koment.

71. Gjykata vëren se ankuesit i kërkohet të përdorë mjetet ligjore që janë mjaft të sigurt jo vetëm në teori, por edhe në praktikë, mospërdorimi i të cilave do të çojë në mungesën e aksesueshmërisë dhe efektivitetit të kërkuar (shih *Bajrami v. Albania*, nr. 35853/04, § 39, ECHR 2006-XIV (ekstrakte)).

72. Në rastin në fjalë, ankuesi depozitoi pa sukses dy padi sipas nenit 59 të KPP-së (shih paragrafët 20 dhe 24 më lart). Duke pasur parasysh fatin e padive të tij të mëparshme ligjore, Gjykata vlerëson se çdo padi tjetër sipas nenit 59 të KPP-së, siç argumentohet nga qeveria, nuk ka perspektivë të arsyeshme suksesi.

73. Për më tepër, duke supozuar se Konventa e Hagës mbi Aspektet Civile të Rrëmbimit Ndërkombëtar të Fëmijëve dhe konventa e kontaktit kanë siguruar bazën e brendshme ligjore për padi tjetër nga ankuesi, Gjykata vëren se, kur është ndjekur një mjet ligjor, nuk kërkohet shterimi i një mjeti tjetër ligjor që në thelb ka të njëjtin objekt (shih, *ndër të tjera, Micallef v. Maltës [GC]*, nr. 17056/06, § 58, ECHR 2009). Në rastin në fjalë, ankuesi ka fituar vendimin përfundimtar të gjykatës shqiptare në favor të tij në lidhje me të drejtën e kontaktit me të birin (shih paragrafin 26 më lart).

74. Prandaj ankimi i ankuesit nuk mund të rrëzohet për mosshkrim të mjeteve të brendshme ligjore dhe, për rrjedhojë, kundërshtimi i qeverisë shqiptare duhet të refuzohet.

c) Konkluzioni

75. Gjykata vëren se ankimi i ankuesit kundër Shqipërisë nuk është haptazi i pabazuar në kuptim të nenit 35 § 3 (a) të konventës. Më tej, ajo vëren se ankimi nuk është i papranueshëm bazuar në ndonjë argument tjetër. Për rrjedhojë, ky ankim duhet të deklarohet i pranueshëm.

B. Meritat (themeli)

1. *Parashtrimet e palëve*

a) *Ankuesi*

76. Ankuesi parashtroi se ka pasur shkelje të nenit 8 të konventës për shkak të dështimit të autoriteteve shqiptare për të siguruar ushtrimin e së drejtës së tij të kontaktit me të birin.

b) *Qeveria*

77. Qeveria shqiptare parashtroi fillimisht se, duke pasur parasysh vendimin e përbashkët të prindërve për të shkuar në Itali në shtator 1999, së bashku me fëmijën e tyre, nuk ka ndodhur asnjë rrëmbim i paligjshëm i djalit të ankuesit. Në procedimet e brendshme ligjore në Shqipëri, ndërkohë që pranohet që fëmija të vazhdojë të mbetet nën kujdestarinë e tezes së tij, ankuesi i kishte kërkuar gjykatës së brendshme zbatimin e së drejtës së tij për të kontaktuar me të birin. Autoritetet kishin marrë të gjitha hapat proceduralë përkatësisht nëpërmjet mjeteve diplomatike, për të siguruar këtë të drejtë. Urdhri i zbatimit ishte regjistruar pranë përmbaruesit, por ekzekutimi i tij ishte objektivisht i pamundur, meqenëse fëmija ishte jashtë juridiksionit të Shqipërisë. Autoritetet ishin përpjekur të marrin informacion për vendndodhjen dhe mirëqenien e fëmijës në vitin 2004. Ato ftuan ankuesin të bëjë një kërkesë pranë autoritetit qendror në përputhje me Konventën e Hagës mbi Aspektet Civile të Rrëmbimit Ndërkombëtar të Fëmijëve.

78. Në lidhje me vendimin e datës 3 mars 2009, qeveria shqiptare deklaroi se gjykatat e brendshme i dhanë të pandehurës dy vjet afat për të zbatuar këtë vendim. Meqenëse afati nuk kishte skaduar në momentin që qeveria parashtroi vëzhgimet e saj më 6 nëntor 2009, ajo argumentoi se nuk lindte asnjë çështje moszbatimi. Për më tepër, legjislacioni i brendshëm ofronte mjete të tjera ligjore, përkatësisht ndërmjetësimi dhe pajtimi për zgjidhjen e çështjeve të tilla.

2. *Vlerësimi i Gjykatës*

79. Gjykata vëren se gëzimi reciprok i prindit dhe i fëmijës në shoqërinë e njëri tjetrit përbën elementin thelbësor të “jetës familjare” në kuptim të nenit 8 të konventës (shih, *ndër të tjera, Eberhard dhe M. v. Sllovenisë*, nr. 8673/05 dhe 9733/05, § 125, 1 dhjetor 2009).

80. Megjithëse objekti kryesor i nenit 8 është mbrojtja e individit kundër ndërhyrjes së pajustificuar nga autoritetet publike, ekzistojnë, gjithashtu, detyrimet pozitive të qenësishme të “respektit” efektiv për jetën familjare (shih, ndërmjet të tjerash, *Maumousseau dhe Washington v. Francës*, nr. 39388/05, § 83, 6 dhjetor 2007). Në të dyja kontekstet, kujdes i duhet kushtuar balancimit të drejtë që duhet të krijohet ndërmjet interesave konkurruese të individit dhe komunitetit në tërësi; në të dyja kontekstet, shteti gëzon një shkallë të caktuar vlerësimi (shih, ndërmjet të tjerash, *Ignaccolo-Zenide v. Rumanisë*, nr. 31679/96, § 94, ECHR 2000-I).

81. Në zbatimin e këtij ushtrimi balancimi, Gjykata do t’i kushtojë rëndësi të veçantë interesave më të mira të fëmijës, të cilat, në varësi të natyrës dhe seriozitetit të tyre, mund të kenë përparësi mbi ato të prindit. Në veçanti, një prind nuk mund të gëzojë të drejtën sipas nenit 8 që të merren masa të tilla që mund të dëmtojnë shëndetin dhe zhvillimin e fëmijës (shih, për shembull, *Sommerfeld v. Gjermanisë* [GC], nr. 31871/96, § 64, ECHR 2003-VIII (ekstrakte); dhe *Neulinger dhe Shuruk v. Zvicrës* [GC], nr. 41615/07, § 134, ECHR 2010).

82. Duke iu kthyer fakteve të çështjes në fjalë, më 30 qershor 2006 gjykata shqiptare pranoi kërkesën e ankuesit për të takuar djalin e tij dy herë në vit. Gjykata urdhëroi Z. të zbatojë vendimin e gjykatës shqiptare. Për këtë qëllim, është lëshuar një urdhër ekzekutimi dhe zyra e përmbarimit është ngarkuar për zbatimin e tij. Gjykata vëren se, ndërkohë që vendimit të gjykatës shqiptare të



datës 30 qershor 2006 i mungonte qartësia në lidhje me modalitetet e kontaktit ndërmjet ankuesit dhe djalit të tij, efektet e këtij vendimi duhet të kuptohen se shtrihen vetëm brenda juridiksionit të Shqipërisë në kuptim të nenit 1 të konventës.

83. Nuk është kundërshtuar nga palët fakti se ankuesi nuk ka mundur të takojë të birin pas dhënies së vendimit të gjykatës shqiptare. Për rrjedhojë, çështja në rastin konkret, përbën qëllimin e detyrimeve pozitive të autoriteteve shqiptare, nëse ka ndonjë, për të zbatuar të drejtën e kontaktit të ankuesit në lidhje me djalin e tij.

84. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se kujdestaria e fëmijës i është besuar tezes së tij, Z., me anë të vendimit të gjykatës italiane 2003. Në asnjë fazë, ankuesi nuk i ka kërkuar gjykatës italiane ndryshimin e vendimit të kujdestarisë së vitit 2003, e aq më pak pranimin e të drejtave të tij të kontaktit apo vizitave.

85. Për më tepër, ankuesi nuk pretendon se fëmija është rrëmbyer apo mbajtur në mënyrë të paligjshme në Itali. Megjithëse gjykatat shqiptare konstatuan se Z. e kishte mbajtur fëmijën në mënyrë të paligjshme, është e diskutueshme nëse ato vlerësuan natyrën e vërtetë dhe qëllimin e vendimit të kujdestarisë tashmë të marrë nga gjykata italiane, meqenëse në asnjë rast nuk i janë referuar këtij vendimi.

86. Për më tepër, në rastet kur fëmija i një ankuesi nuk ishte brenda juridiksionit të shtetit të paditur dhe, pavarësisht nëse ankuesi kishte filluar procedimet ligjore sipas Konventës së Hagës mbi Aspektet Civile të Rrëmbimit Ndërkombëtar të Fëmijëve dhe nëse janë dhënë të drejtat e kujdestarisë, Gjykata ka konstatuar se ankuesit i është kërkuar të paraqesë çështjen për ushtrimin e të drejtave të aksesit, kontaktit ose vizitave të tij në shtetin e paditur në juridiksionin e të cilit është konstatuar fëmija. Për shembull, në *Deak v. Rumanisë dhe Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 19055/05, 3 qershor 2008, ku ankuesi filloi procedurat sipas Konventës së Hagës mbi Aspektet Civile të Rrëmbimit Ndërkombëtar të Fëmijëve në Rumani dhe në Mbretërinë e Bashkuar në lidhje me largimin e paligjshëm të të birit prej nënës së fëmijës nga Rumania për në Mbretërinë e Bashkuar, Gjykata konstatoi se për sa kohë që procedurat pranë gjykatave rumune nuk vendosnin menjëherë mbi çështjen e të drejtave të aksesit të ankuesit, të cilat ishin miratuar paraprakisht me anë të vendimit të gjykatës rumune, ankuesi, i cili nuk kishte kujdestarinë e fëmijës, mund t'i ishte drejtuar gjykatave angleze për zgjerimin e të drejtave të tij të aksesit ose për ndryshimin e mënyrës së ushtrimit të këtyre të drejtave (paragrafi 69). Në *Stenzel v. Polonisë*, (dec.), nr. 63896/00, 28 shkurt 2006, megjithëse gjykatat polake nuk i hoqën ankuesit të drejtat e tij prindërore, në mungesë të procedurave të paraqitura sipas Konventës së Hagës mbi Aspektet Civile të Rrëmbimit Ndërkombëtar të Fëmijëve, Gjykata konstatoi, në lidhje me të drejtat e aksesit të ankuesit, se ai nuk i kishte kërkuar në asnjë rast autoriteteve gjermane ndihmë sipas konventës për të siguruar të drejtën që të vizitonte fëmijën e tij në Gjermani.

87. Në dritën e praktikës ligjore të mësipërme dhe duke pasur parasysh rrethanat e veçanta të rastit në fjalë, neni 8 nuk mund të kuptohet si zgjerim i detyrimit të një shteti të paditur për t'i siguruar ankuesit kontaktin kur fëmija është transferuar në një juridiksion tjetër dhe është jashtë juridiksionit të këtij shteti (shih, për shembull, *Stenzel*, cituar më lart). Për më tepër, neni 8 i konventës, i parashikuar në dritën e Konventës së Hagës mbi Aspektet Civile të Rrëmbimit Ndërkombëtar të Fëmijëve, nuk u cakton autoriteteve kombëtare detyrime pozitive për të siguruar kthimin e fëmijës nëse ankuesi mban vetëm të drejtat e kontaktit ose vizitave (shih, *R.R v. Rumanisë* (nr. 1), nr. 1188/05, § 164, 10 nëntor 2009; krahaso *Bajrami*, cituar më lart, ku shteti i paditur kishte detyrime pozitive për të siguruar zbatimin e vendimit të kujdestarisë dhënë në favor të ankuesit; krahaso *Eberhard dhe M. V. Sllovenisë*, nr. 8673/05 dhe 9733/05, 1 dhjetor 2009 dhe *Siemianowski v. Polonisë*, nr. 45972/99, 6 shtator 2005, ku detyrimet pozitive të shteteve të paditura për të siguruar zbatimin e marrëveshjes së kontaktit, që nuk ishte urdhëruar brenda kuadrit të Konventës së Hagës mbi Aspektet Civile të Rrëmbimit Ndërkombëtar të Fëmijëve, shtriheshin tërësisht brenda juridiksionit të tyre).

88. Për këtë arsye, Gjykata konkludon se, meqenëse të dy prindërit kanë rënë dakord me dëshirën e tyre për të udhëtuar me fëmijën në Itali dhe meqenëse fëmija mbeti në Itali në bazë të urdhrit të ligjshëm të dhënë nga gjykata italiane, e cila nuk i njohu ankuesit të drejtat e kujdestarisë, nuk kishte detyrim pozitiv për Shqipërinë për të marrë hapa për të siguruar zbatimin e të drejtave të kontaktit të ankuesit me djalin e tij, siç njihet nëpërmjet vendimit të gjykatës shqiptare. Ankuesi duhet të kishte depozituar padi pranë gjykatës italiane për të fituar të drejtat e kontaktit ose vizitave në lidhje me djalin e tij.

89. Për rrjedhojë, nuk ka pasur shkelje të nenit 8 të konventës.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA, UNANIMISHT:

1. *Deklaron* ankesën sipas nenit 8 të konventës në lidhje me Shqipërinë të pranueshme, ndërsa pjesën e mbetur të kërkesës në lidhje me Italinë të papranueshme;

2. *Gjykon* se nuk ka pasur shkelje të nenit 8 të konventës në lidhje me Shqipërinë.

Bërë në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim më 8 janar 2013, sipas nenit 77 §§ 2 dhe 3 të rregullores së gjykatës.

Fatoş Arac¹⁾
Regjistrues

Ineta Ziemele
President

SEKSIONI I KATËRT

VENDIM

KËRKESE NR. 54188/08

VJOLLCA CEKANI KUNDËR SHQIPËRISË

Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut (seksioni i katërt), e mbledhur më 23 tetor 2012, duke gjykuar si Dhomë e përbërë nga:

George Nicolaou, *president*

Ledi Bianku

Vincent A.De Gaetano, *gjykatës*

dhe Fatos Araci, *zëvendësregjistrues*

FAKTET

1. Ankuesja, Znj. Vjollca Cekani, është shtetase shqiptare, e cila ka lindur në vitin 1952 dhe banon në Gjirokastrë.

2. Qeveria shqiptare (qeveria) u përfaqësua nga agentja e saj, Znj. L. Mandia e Avokaturës së Shtetit.

A. Rrethanat e çështjes

3. Në vijim të largimit nga puna të kërkueses, më 23 qershor 2008, Gjykata e Apelit Gjirokastrë urdhëroi punëdhënësin e saj, Bashkinë Gjirokastrë, t'i paguajë ankueses pagën e shtatë muajve, nuk u urdhërua asnjë rikthim në pozicionin e mëparshëm të punës.

4. Më 23 tetor 2008 është lëshuar një urdhër përmbarimi. U përllorarit se shuma që duhet t'i paguhej ankueses ishte 800,000 lekë, përveç taksës për përmbaruesin.



Kryerja e procedurave të përbarimit

5. Me anë të letrës së 24 korrikut 2009, punëdhënësi i ankueses e informoi zyrën e përbaruesit se kështu e rregullta ishin transferuar në llogarinë bankare të ankueses. Si rrjedhojë, detyrimi prej 400,000 lekë ishte paguar që më 1 dhjetor 2008, ndërsa shuma e mbetur do të paguhej me kështu të rregullta.

6. Më 12 korrik 2010, ankuesja deklaroi me shkrim se iu pagua shuma prej 800,000 lekë.

7. Më 20 shtator 2010, ankuesja kërkoi me shkrim që procedurat e përbarimit të përfundonin me argumentin se vendimi ishte zbatuar i plotë. Si rrjedhojë, më 21 shtator 2010, zyra e përbaruesit vendosi t'u jepte fund procedurave të përbarimit. Vendimi mori formë të prerë dhe asnjë ankimim nuk u paraqit kundër tij.

B. Ligji dhe praktika e brendshme përkatëse

8. Ligji dhe praktika e brendshme përkatëse janë përshkruar në çështjet Qufaj CO. sh.p.k. kundër Shqipërisë (nr. 54268/00, && 21-26, 18 nëntor 2004) dhe Gjyli kundër Shqipërisë (nr. 32907/07, && 19-28, 29 shtator 2009).

ANKIMIMI

9. Ankuesja paraqiti ankimim sipas nenit 6&1 të konventës, se vendimi i Gjykatës së Apelit Gjirokastër i datës 23 korrik 2008 nuk ishte zbatuar.

LIGJI

10. Ankuesja paraqiti ankimim lidhur me moszbatimin e vendimit të formës së prerë në favor të saj.

11. Qeveria pretendoi se vendimi i formës së prerë në favor të ankuesit u zbatua brenda një kohe të arsyeshme.

12. Duke pasur parasysh parimet e përgjithshme që rrjedhin nga drejta zakonore lidhur me zbatimin e vendimeve të formës së prerë të gjykatave të brendshme (shih, për shembull, Qufaj Co. sh.p.k., cituar më sipër, & 38; dhe Gjyli, cituar më sipër, & 43-44), gjykata gjykon se ankesa duhet të shpallet e papranueshme si e pabazuar hapur në argumente për arsyet e parashtruara më poshtë.

13. Nga dokumentet rezulton, e pakontestuar nga palët, se autoritetet vepruan me shpejtësi dhe me kujdes për të siguruar pajtimin me gjykimin përfundimtar për borxhin. Për shembull, autoritetet bënë pagesa të rregullta në llogarinë bankare të ankuesit, duke filluar nga 1 dhjetori 2008. Nga 24 korriku 2009, ato kishin shlyer gjysmën e shumës së papaguar. Më 21 shtator 2010, gjykimi për borxhin ishte ekzekutuar në mënyrë të plotë dhe, me kërkesë së ankueses, procedurat e përbarimit u mbyllën. Për më tepër akoma, gjatë kohës kur u paraqit ankesa, ankuesja paraqiti ankesë lidhur me moszbatimin e vendimit të formës së prerë të gjykatës, vendim, i cili, si rrjedhojë, u zbatua në mënyrë të plotë. Asnjëherë gjatë procedurave para gjykatës ankuesja nuk paraqiti ankesë lidhur me kohëzgjatjen e procedurave të përbarimit, që gjykata nuk i konsideron të papajtueshme me kriteret e "kohës së arsyeshme" sipas nenit 6&1 të konventës (shih, për shembull, Denisov kundër Ukrainës (vend), nr. 18512/02, 1 shkurt 2005; Zhovtan kundër Ukrainës (vend), nr. 170044/02, 22 nëntor 2005' dhe, *mutatis mutandis*, Kovalenko dhe Boyko kundër Ukrainës (vend), nr. 15066/03, 30 nëntor 2010).

14. Në kuadër të asaj që përmendet më lart, gjykata konkludon se çështja nuk paraqet ndonjë shkelje të nenit 6&1 të konventës. Ajo vijon se ankesa është hapur e pabazuar në argumente dhe duhet të refuzohet në mbështetje të nenit 35&&3 (a) dhe 4 të konventës.

Për këto arsye, gjykata në mënyrë unanime

E shpall ankesën të papranueshme.

Fatoş Araci
Zëvendësregjistrues

George Nicolaou
President

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.

Hyri në shtyp më 18.2.2013
Doli nga shtypi më 18.2.2013

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2013

Çmimi 30 lekë